



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

### V E N D I M

Nr. 10, datë 29/01 /2018

Për

Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit të vitit 2019

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.Shqipërisë”, të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit”, dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, dhe bazuar në projektin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

### V e n d o s i :

I.Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe të Buxhetit të vitit 2019, si më poshtë;

Nr	Përshkrimi i Veprimtarisë së Punës	Afati	I ngarkuar për zbatim
1	Përgatitja dhe dërgimi në këshill për miratim të Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit Vjetor 2019.	Deri më datë 15.12.2017	Kryetari i Bashkisë
2	Miratimi i Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe të Buxhetit Vjetor 2019	Deri më datë 31.12.2017	Këshilli i Bashkisë
3	Përgatitja dhe paraqitja në këshill të Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimeve Afatmesme të të ardhurave për; -dy vitet para vitit buxhetor, viti buxhetor dhe tre vitet e ardhshme. Në raport duhet të parafshihen; -metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave; -analiza të efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimet e tyre; -analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre;	Deri më 20.02.2018	Drejtoria e të Ardhurave Vendore
4	Përgatitja dhe paraqitja në këshill i prioriteteve dhe projekteve për investimet publike, si dhe kostot e tyre përkatëse. Qëllimet dhe objektivat e politikave sipas programeve, duke u adresuar edhe në respektimin e plotë të barazisë gjinore.	Deri më 20.02.2018	Drejtoria e Prog. Zhvillimit dhe e Urbanistikës

5	Miratimi i Raportit të Vlerësimeve dhe Parashikimeve afatmesme të të ardhurave, prioriteteve dhe projekteve të investimeve publike për tre vite.	Deri më 01.03.2018	Këshilli i Bashkisë
6	Përgatitja dhe paraqitja në këshillin e bashkisë të tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2019-2021 në nivel programi.	Deri më 05.03.2018	Drejtoria Financë-Buxhet
7	Miratimi i tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2019-2021 në nivel programi.	Deri më 15.03.2018	Këshilli i Bashkisë
8	Hartimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e buxhetit dhe PBA-së, i cili duhet të përmbajë; -Përcaktimin e programeve buxhetore dhe E.M.P përkatëse; -Tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet; -Afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të PBA-së Faza e I <sup>re</sup> .	Deri më datë 20.03.2018	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
9	Miratimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e P.B.A-së dhe të buxhetit vjetor.	Deri më datë 20.03.2018	Kryetari i Bashkisë
10	Dërgimi i udhëzimit, manualit shpjegues dhe pasqyrave përkatëse për plotësim nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit (drejtoritë).	Deri më datë 25.03.2018	Drejtoria Financë-Buxhet
11	Plotësimi i pasqyrave, paraqitja e kërkesave buxhetore dhe e kërkesave shtesë sipas programeve nga drejtuesit e EMP, dhe dorëzimi i tyre në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Faza e I <sup>re</sup> .	Deri më datë 15.05.2018	Drejtesit e E.M.P-it (Drejtoritë)
12	Zhvillimi i dëgjesave publike dhe i konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit, lidhur me nivelin e taksave dhe tarifave, si dhe për prioritetet e investimeve ndër vite.	Nga data 15-25.05.2018	-Kryetari i Bashkisë -G.M.S-ja
13	Përgatitja dhe paraqitja për vlerësim e miratim nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i PBA-së dhe kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtuesit e programeve (EMP).	Deri më datë 25.05.2018	-Drejtoria e Financës. - G.M.S-ja
14	Dërgimi me shkrim dhe në rrugë elektronike të projektdokumentit të PBA-së për vitet 2019-2021, në Ministrinë e Financave.	Deri me datë 01.06.2018	Drejtoria e Financës
15	Paraqitja për miratim në këshillin e bashkisë, të dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm për vitet 2019-2021, të miratuar nga GMS-ja, së bashku me raportin e vlerësimit të dërguar nga M.Financave.	Deri më datë 20.06.2018	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
16	Shqyrtimi dhe miratimi i projektdokumentit të parë të PBA-së nga ana e këshillit bashkiak.	Deri më datë 30.06.2018	Këshilli i Bashkisë
17	Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së të miratuar nga ana e këshillit bashkiak.	Deri më datë 05.07.2018	Këshilltari i Medias, Drejtoria e Financës
18	Përgatitja dhe paraqitja në këshill, e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	Deri më datë 10.07.2018	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
19	Shqyrtimi dhe miratimi i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi	Deri më datë 20.07.2018	Këshilli i Bashkisë
20	Hartimi i udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, i cili përmban: -Tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për secilin nga tre vitet e ardhshme; -afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të PBA-së. Ky udhëzim i miratuar nga ana e Kryetarit Bashkisë, ju dërgohet të gjithë drejtuesve të EMP-it (Drejtorive).	Deri më datë 25.07.2018	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
21	Pas finalizimit të projektdokumentit të PBA-së të rishikuar, e të publikuar, të organizohen dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit. Në këto takime duhet të mbahen procesverbale, të bëhen regjistrime filmike, të cilat do të bëhen pjesë e dokumentit të PBA-së	Gjatë muajit Gusht 2018	-Kryetari i Bashkisë -Këshilli Bashkisë
22	Përgatitja dhe paraqitja për miratim në këshilli i dokumentit të rishikuar të PBA-së.	Deri më datë 05.09.2018	-Dr.Financës. - G.M.S-ja
23	Miratimi në këshill i dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021.	Deri më datë 10.09.2018	Këshilli i Bashkisë

24	Dërgimi në Ministrinë e Financave të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli, me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga M.Financave në fazën e parë.	Deri më datë 15.09.2018	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
25	Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga Ministria e Financave, të bëhet përgatitja e projektit PBA-së përfundimtar dhe projektbuxhetit për vitin 2019, si dhe dërgimi i tij për miratim në këshill.	Deri më datë 30.11.2018	Drejtoria e Financës dhe E.M.P-it
26	Shqyrtimi dhe miratimi nga këshilli bashkiak i projektdokumentit të PBA-së dhe projektbuxhetit për vitin 2019.	Deri më datë 25.12.2018	Këshilli i Bashkisë
27	Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së dhe buxhetit për vitin 2019, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij.	Deri më datë 31.12.2018	-Drejtoria e Financës. - G.M.S-ja

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Kristian GJIDODAJ**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot, Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018

Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Prefektit të Qarkut Lezhë

Arkivës së Bashkisë



**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Eraldo DEDA**